

Tiranë, më 09.05.2021

KA-40

07.05.2021
09:13:52

ANKIM

ANKUES:

Partia Demokratike e Shqipërisë, me seli në adresën: Blv. Zhan d'Ark, Nr. 11, Tiranë, përfaqësuar nga Sekretari për Çështjet Zgjedhore **Ivi KASO**, me adresë email-i: ivikaso@gmail.com dhe nr.tel: (+355) 68 20 77 094.

OBJEKTI:

1. Kundërshimi i Vendimit Nr. 344, datë 04.05.2021 "Për miratimin e Tabeles Përmbledhëse për Rezultatit në zonën zgjedhore Qarku Elbasan, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021".
2. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Elbasan.
3. Urdhëzimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Elbasan në periudhën më të afërt zgjedhore.

BAZA LIGJORE:

Nenet 1, 18, 35, 45 dhe 64 të Kushtetutës së Shqipërisë;
Nenet 8 dhe neni 3, Protokolli 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
Pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore;
Nenet 12, pika 4; 21, pika 1; 33, gërma "e"; 91; 92; 98, pika 4; 106, pika 1; 113, pika 1; 116, pikat 6/7; 116/1, pika 5; 117, pika 2/3/4; 118, pika 1/2; 122, pika 2/5; 123, pika 4; 123/1, pikat 1 dhe 2; 124, pikat 1 dhe 3; 143, pika 1, gërmat "ç" dhe "d"; 160, pika 1, gërma "s" dhe 2; 161, pika 1 të Kodit Zgjedhor;
Nenet 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale";
Nenet 3 dhe 6 të Vendimit Nr. 9, datë 24.12.2020 të KQZ-së.

DREJTUAR:

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

Te Nderuar,

Në datën 04.05.2021, kemi marrë dijeni për Vendimin Nr. 344, datë 04.05.2021 "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatit në zonën zgjedhore Qarku Elbasan, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të dates 25 prill 2021" të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, për shkak se vlerësojmë se gjatë procesit zgjedhor prej të cilit ka dalë ky vendim kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor, si dhe tërësia e shkeljeve të ligjit, të ndodhura në këtë zonë zgjedhore ka cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që ka ndikuar në ndarjen e mandateve, sic do të provohet gjatë hetimit administrativ, po parashtrojmë këtë ankim me faktet, dispozitat ligjore dhe arsyetimin ligjor, si më poshtë:

I. RRETHANAT E ÇËSHITJES

1. Në datën 25.04.2021, u zhvilluan zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Në zonën zgjedhore Elbasan morën pjesë në zgjedhje 166.048 votues ose 44.96%. Në datën 26 dhe 27 Prill, u krye numërimi i votave për subjektet zgjedhore, gjatë të cilit u konstatuan 156.162 fletë të vlefshme dhe 9776 fletë të pavlefshme ose 5.88%.
 2. Mandatet në këtë zonë zgjedhore u ndanë, si vijon: PS 8 mandate dhe PD 6 mandate. Diferenca ndërmjet votave të subjektit zgjedhor PS për mandatin e fundit me subjektin zgjedhor PD AN ishte 2510 vota ose 7266 më pak vota se numri i votave të pavlefshme.
 3. Në datën 04.05.2021, me vendimin Nr. 344, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit në zonën zgjedhore Qarkut Elbasan, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputet, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.
 4. Duke qenë se jemi të bindur, bazuar në prova dhe fakte të pakundërshtueshme, se periudha para dhe zgjedhore u shoqërua me shkelje të ligjit, të cilat cënuan rëndë procesin zgjedhor në një masë të tillë që ndikoi drejtpërdrejtë në ndarjen e mandave, në vijim do të parashtrojmë faktet që mbështesin këtë pretendim:
- A. **Blerja e votës dhe përdorimi i personave me precedentë të tmerrshëm kriminalë (11 prova):**

5. Partia Socialiste kishte drejtues politik për Qarkun e Elbasanit Taulant Ballën, deputet në detyrë i Kuvendit të Shqipërisë. Z. Balla është organizatori i një skeme kriminale, që përfshin një numër të konsiderueshëm personash, me role të ndryshme në grup. Astrit Sufeli, i njohur ndryshe si "i forti i Peqinit" është person me rekorde të checksuara kriminale dhe i dënuar për vrasje, megjithatë kjo nuk e pengon këtë shtetas që të jetë shoqëruesi i Taulant Ballës në takimet elektorale në Elbasan. (Prova Nr. 1).
6. Qarku i Elbasanit është një nga qarqet më problematike lidhur me sigurinë dhe rendin publik në të gjithë territorin e Shqipërisë, pasi Qarku kontrollohet nga bandat (Prova Nr.2). Lista shumëemërore e PS në Qarkun e Elbasanit, ndër të tjera, përbëhet nga shtetasit **Klevis Xhoxhi, Besian Ajazi, Desantila Tahiraj, Saimir Hasalla**, të gjithë këta me lidhje të forta me grupe kriminale ose persona me rekorde kriminale. Shtetasi **Klevis Xhoxhi** është nipi i gruas së ish-Kryetarit të Bashkisë Elbasan, Qazim Sejdiu, i cili mbështetet fuqishëm nga grupi kriminal i Suel Çelës (Prova Nr. 3). Shtetasi **Besian Ajazi** është ish-këshilltar i Taulant Ballës, aktualisht kandidat për deputet dhe vëllai i Drejtuesit të Prokurorisë Kreshnik Ajazi, i cili e ka marrë detyrën para rreth një viti dhe ka nën kontroll çdo betim që mund të tentojë të zhvillohet ndaj grupeve kriminale në lidhjet e tyre me procesin zgjedhor (Prova Nr. 4). Shtetasja **Desantila Tahiraj**, në poziticionin e Drejtorit të Spitalit Rajonal Elbasan, është e njohur për abuzimet me detyrën, panësimet e paligjshme dhe veprimet korruptive gjatë ushtrimit të detyrës (Prova Nr. 5). Ndërsa shtetasi **Saimir Hasalla**, është dhëndër i ish-deputetit Aqif Rakipi, mbështetet fort nga grupi kriminal i Ardian Rakipit, që është dhe vëllai i Aqif Rakipit. Ardian Rakipi është ndër trafikantët më të fuqishëm të drogave të forta dhe jo vetëm në vend, me aktivitete në Hollandë, Itali dhe Angli (Prova Nr. 6).
7. Gjatë periudhës Mars – Prill 2021, Partia Demokratike ka depozituar **50 kallëzime penale në SPAK dhe 130 kallëzime në prokuroritë e rretheve**. Ndër 50 kallëzimet e depozituara në SPAK, 30 prej tyre kanë të bëjnë me raste flagrante të shitblerjes së votës nga drejtues, përfaqësues apo mbështetës të Partisë Socialiste.
8. Në Qarkun e Elbasanit për rastet e shitblerjes së votës dhe shkelje të tjera flagrante të ligjit që kanë rënduar rëndë procesin zgjedhor, Partia Demokratike ka depozituar **dy kallëzime penale në SPAK** gjatë fushatës zgjedhore në datat **23.02.2021 dhe 07.04.2021**, përkatësisht:
 - (i) Në datën 23.02.2021, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – SPAK, shtetasin Taulant Balla, si edhe çdo person tjetër të pidentifikuar, por që me veprime dhe mosveprime ka

konsumuar veprat penale të "Korrupsionit aktiv në zgjedhje" parashikuar nga neni 328, dhe "Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore" parashikuar nga neni 328/a i Kodit Penal (Prova Nr. 7). Taulant Balla duke shfrytëzuar VKM nr. 85, datë 10.02.2021 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe mjetëve nujorë të pëfshirur në ndihmën ekonomike dhe përdorimit të fondit shtetëror në fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", ka përdorur dyfishimin e përkohshëm të ndihmës ekonomike për përfitime politike. Kjo vërtetohet edhe nga komunikimet në fjalë dallohet qartë mesazhi "Përbëndetje, ju ftoj nga zyra e Ntabit të Taulant Ballës dhe dua tju informojë se ndihma juaj ekonomike është dyfishuar nga Shteti deri në Qershor. Kjo është mundësuar nga Taulant Balla. Pretini mbështetjen tuaj. Falënderim". Një pjesë e përfituesve, edhe janë kërcënuar për mospërfitim të saj në rast se nuk mbështesin Partinë Socialiste.

- (ii) Në datën 07.04.2021, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – SPAK, skemën kriminale të blerjes së votës nga persona me rekorde kriminale në Qarkun e Elbasanit, duke konsumuar veprat penale të "Grup i Strukturuar Kriminal" parashikuar nga neni 333/a, "Pengimi i subjekteve zgjedhore" parashikuar nga neni 325, "Korrupsioni aktiv në zgjedhje" parashikuar nga neni 328, "Marrja ose përdorimi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit" parashikuar nga neni 331/a dhe "Shpërdorimi i autoritetit policor" parashikuar nga neni 332/a të Kodit Penal (Prova nr. 8).

9. Faktet dhe grup-faktet e evidentuara të blerjes së votës në Qarkun Elbasan nga eksponentë të PS dhe persona me rekorde të tmerrshme kriminale në shërbim të PS, janë evidentuar dhe faktuar nga ana e PD gjatë fushatës zgjedhore si më poshtë:

- (i) Në qarkun e Elbasanit, nga ana e kandidatëve të Partisë Socialiste është ngritur një infrastrukturë kriminale që cenon standardet e zgjedhjeve. Konkretisht, nga informacioni dhe të dhënat e mbledhura nga strukturat e Partisë Demokratike është vërejtur një rritje e aktivitetit kriminal në Qarkun e Elbasanit, i cili konsiston kryesisht në kërcënimin e strukturave të Partisë Demokratike nga eksponentë të krimit të organizuar, blerjen e votova kundrejt shumave të caktuara në vlerë monetare, premtimeve për punësim nga ana e eksponentëve të Partisë Socialiste që operojnë në Qarkun e Elbasanit, kanosjes për largime nga puna, mbledhjen e mjeteve identifikuese

si ID apo Pasaporta të qytetarëve. I gjithë ky mekanizëm është mirëmenduar dhe i mirëorganizuar pasi individë të caktuar operojnë në zona të ndryshme të qytetit, sidomos në lagjet periferike të tij ku dhe ndjehet më shumë ndikimi ekonomik, me qëllimin e verës për cenimin e vullnetit të qytetarëve në zgjedhjet e 25 prill 2021 në favor të Partisë Socialiste (Prova Nr. 8).

- (ii) Shtetasi Suel Çela, shtetasi Klemend Ymer Xhaferri, shtetasi Marsel Agron Broka, shtetasi Gëzim Shpendi Rusi, shtetasi Ernaldo Përparim Metaj, shtetasi Ernest Mustafa Skilja dhe shtetasi Mehmet Greca janë angazhuar në veprime penguese përmes kanosjes, dhunës, apo çdo mënyrë tjetër ndaj subjekteve zgjedhore në mënyrë që këto të fundit të zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin gjatë fushatës zgjedhore. Shtetasit e lartpërmendur janë të lidhur në mënyrë direkte me Drejtuesin Politik të PS në Qarkun e Elbasanit, shtetasin Taulant Balla. Ky grup është përfshirë edhe në kanosjen me jetë të strukturave dhe mbështetësve të Partisë Demokratike. Konkretisht, më datë 15.03.2021 në orën 15:30 në zyrat elektorale të PD-së në lagjen "5 Maj" dhe "Vullnetar", anëtarët e këtij grupi nën drejtimin e shtetasit Klemend Xhaferri dhe Ernaldo Metaj dhe dy shtetas të tjerë të pa identifikuar nga ana e jonë, kanë kërcënuar me jetë dhe kanë urdhëruar përmes kërcënimeve "për vrasje". Po të njëjtën ditë në orën 16:20 është kërcënuar stafi në zyrën elektorale pranë NSHU. Më datë 17.03.2021 ora 11:00 shtetasi Ernaldo Metaj ka kërcënuar në mënyrë të përsëritur pjesëtarët dhe stafin e pranishëm në zyrën elektorale në lagjen "5 Maj" (Prova Nr. 8).

- (iii) Po ashtu shtetasi **Suel Çela**, si dhe shtetasit Klemend Xhaferri dhe Ernaldo Metaj kanë telefonuar dhe kanosur me jetë të gjithë zinxhirin drejtues të strukturës së Partisë Demokratike Elbasan, dhe anëtarë aktiv që mbështetën fushatën e Partisë Demokratike, duke iu kërkuar të ndalojnë menjëherë fushatën elektorale për PD. Gjatë kësaj jave, anëtarët e grupit kriminal **Endi Haxhia, Mario Çela dhe Gëzim Rusi**, pasi identifikojnë votues dhe mbështetës të Partisë Demokratike, i kanosin këta të fundit me jetë në rast të angazhimit apo votimit për Partinë Demokratike. Kanosja është bërë nëpërmjet ndalimit të automjetit në vendin ku ndodheshin personat subjekt të shantazhit. Automjetet që janë përdorur për këtë qëllim nga ana e shtetasve të nënsipër janë automjetet me targa AB662BJ, AA750SF, AB010MM, AA333SD,

AB001MN dhe një automjet tjetër i llojit Mercedes Benz Vitro Blind me tatiga të huaja (Prova Nr. 8).

- (iv) 43 shtetas janë kallezuar penalisht nga ana e Partisë Demokratike në në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – SPAK, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal për kryerjen e veprave penale të "Pengimit të subjekteve zgjedhore", parashikuar nga neni 325 i Kodit Penal, "Korrupsion aktiv në zgjedhje" parashikuar nga neni 328, "Marja ose përdorimi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit" parashikuar nga neni 331/a dhe për veprën penale të "Shpërndarjes së autoriteti policor" të parashikuar nga neni 332/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Të gjithë këta shtetas kanë vepruar në zona të ndryshme të qytetit dhe rrethinave (Prova Nr. 8).
- (v) Shtetasi **Gjergj Luca**, pronari i kompleksit "Rozafa" ka kryer mbledhje të paligjshme të dokumenteve të identifikimit për një numër të konsiderueshëm të punonjësve të tij, si dhe është angazhuar drejtpërdrejtë në skemën kriminale të blerjes së votave, duke përdorur një rrjet personash të punësuar prej tij, që kanë bërë shpërndarjen shpërndarjen e parave pas hyrjes në fuqi të aktit të qarkullimit për shkak të pandemisë "COVID-19. (Prova Nr. 8).
- (vi) Shtetasi **Dashamit Myzeqari** ka bërë mbledhjen e dokumenteve të identifikimit në lagjen e njohur si "Tek Çerdhja". Shtetasja **Drita Luli**, punonjëse tek Posta Shqiptare Elbasan, ka mbledhur mbi 10 letër njoftime ID, e cila pranon se këtë gjë e ka kryer e detyruar nga drejtuesit e saj në poste . (Prova Nr. 8).
- (vii) Shtetasit **Artan Faik Firaku** dhe **Xhevahir Njelina**, gjatë fushatës zgjedhore kanë operuar tek lagja "5 Maji" dhe në këtë lagje kanë mbledhur mbi 100 letër njoftime ID. Tek lagja "5 Maji" ka vepruar gjithashtu shtetasi **Afrim Vullnetari**, i cili veprimtarinë e tij të shpërndarjes së parave dhe mbledhjes së kartave të identitetit e ka kryer në lokalitë të njohur si "Lokali me Harqe", që shërben edhe si bazë e shpërndarjes së letërve narisotik. Në këtë lagje, janë angazhuar duke kryer veprime të kundraligjshme edhe shtetasit **Endi Haxhia**, **Mario Çela** dhe **Gëzim Rusi**. (Prova Nr. 8).
- (viii) Në zonën e Bradasheshit kanë operuar kryesisht shtetasi **Ledi Hoti (Ledian)**, i cili ka bërë shpërndarjen e parave në këmbim të votës për Partinë Socialiste dhe shtetasi **Arben Veseli**, i cili po ashtu ka kryer shpërndarje parash dhe mbledhje të ID. Në zonën e Bradasheshit ka operuar edhe **Gentian Mustafa Sharra** i datëlindjes

14.07.1974, lindur dhe batur në Elbasan, person me rekorde kriminale, i cili vendosi në dispozicion gjithë ambicinet në pronat e tij, kryesisht në lokalitë përgjatë rrugës së vjetër rrethrotullimi Bradasheshit me urën e Zaranikës, një rrjet personash organizoheshin dhe bënin shpërndarjen e parave për votues në zonën e Bradasheshit dhe Fushë Mbretit. Në Fushë Mbret, ka operuar me mbledhjen e dokumenteve të identifikimit dhe blerjes së votave edhe shtetasi Fadil Meta, i cili është punonjës i Policisë së Shtetit. Me mbledhjen e dokumentave të identifikimit dhe blerjen e votave në Fushë Mbret janë angazhuar edhe shtetasit Marsel Rroka dhe Klement Xhaferri (Prova Nr. 8).

- (ix) Në zonën "11 nëntori" dhe në zonën "Haqet-Pirakasit", shtetasi **Arjan Sinani**, me detyrë ish-police bashkiak ka ofruar në këmbim të votës për Partinë Socialiste 5.000 lek të reja. Po në zonën "11 nëntori" janë angazhuar në mbledhjen e dokumentave të identifikimit dhe blerjes së votave edhe shtetasi **Tit Muzhaqi** dhe **Gent Derzeza**. Shtetasi **Aurel Safret Kaja**, i datëlindjes 15.04.1976, me detyrë Drejtor i Ujësjellës Kanalizimeve në Bashkinë e Elbasanit, por ish-Drejtor i Policisë Bashkiake, është përfshirë personalisht në shpërndarjen e parave, madje ka ngritur edhe një rrjet të gjerë personazh që merret me shpërndarjen e parave (Prova Nr. 8).
- (x) Në lagjen "Ermin Matraxhiu" ka vepruar shtetasja **Dhurata Shyqyri Mata**, e datëlindjes 10.10.1974, e cila mban detyrën e Shërfes së Sektorit të Burimeve Njerëzore në Helkurudhë dhe pozicionin e Kryetares së Gruas Socialiste. Kjo shtetase ka mbledhur kartat e ID-së kundrejt shumës së 50.000-70.000 lekëve. Disa prej shtetasve, të cilët u është marrë karta e ID janë: Luljeta Kotorni, Zenepe Mustafa Tomorrica, Flamur Feti Bullaj, Veli Ibrahim Buzani, Afërdita Veli Buzani, Ruzhdi Veli Buzani, Samir Veli Buzani dhe Shkelqim Mustafa Kargjezi (Prova Nr. 8).
- (xi) Në lagjen "Dyli Haxhiu" me blerjen e votave dhe mbledhjen e dokumentave të ID ishte angazhuar **Arian Ibershimi**, ndërsa në lagjet "Rruga e re e Trenit" dhe "Haxhias" ishin aktivizuar në blerje votash dhe mbledhje ID shtetasit **Met Peqini** (Meti Tujës), **Tit Caka**, **Shaqir Prroi**, **Donald Varfi** dhe **Shyqyri Hoxha** (Prova Nr. 8).
- (xii) Shtetasit **Gen Coku**, **Ervin Gjoka**, **Durim Koci**, **Ligor Macolli**, **Durim Sadiku**, **Art Majori**, **Gjel Ndreca**, **Shkelqim Deliu**, **Kujtim Haka**, **Ibrahim Musmuca**, **Altin Fizaku**, **Shazivar Haka**, janë angazhuar në skemën e shpërndarjes së parave dhe mbledhjes së kartave në disa zona të qytetit të Elbasanit. Ndërsa **Agton Rrokaj**, Shefi

i Burimeve Njerezore në IEVP Elbasan, dhe Krenar Kasi, me detyrë Komandant i Grupit të Shoqërimit në IEVP Elbasan veprojnë në paraburgimin e Bradasheshit, duke shantazhuar të burgosurit, me qëllim që këta të fundit dhe familjarët e tyre të votojnë PS në zgjedhjet e 25 Prillit (Prova Nr. 8).

10. Të gjitha sa më sipër të provuara dhe faktuara gjenden në aneksin 1 të kësaj ankese, veçanërisht kallëzimet penale të datës 23.02.2021 dhe 07.04.2021, si dhe 9 provat e më sipërme. Faktet dhe grup-faktet e paraqitura provojnë katërcipërisht shkelje të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor me qëllimin e qartë për të ndikuar mbi rezultatit zgjedhor dhe ndarjen e mandateve. Partia Demokratike ka denoncuar në mënyrë të vazhdueshme faktin se në zonën zgjedhore Qarku Elbasan nuk kishte përballë saj një parti politike dhe kandidatët e saj që gatoheshin me një ofertë politike, por grupe të strukturuar dhe banda kriminale që blinin vota, kërcënonin qytetarët, intimidonin nëpunësit publikë, shpërndanin leje legalizimi/ndërtimi, licenca dhe shpërblyeme.
11. Në datën 21 prill, strukturat e Partisë Demokratike pasi pikasën një mjet të dyshimtë dhe bënë ndalimin e tij densa Policia të mbërritën. Gjatë përplasjes fizike në prezencë të Policisë së Shtetit, një shtetas ndërroi jete. Më datën 22 prill, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dha një deklaratë për shtyp lidhur me ngjarjen dhe theksoi se asnjë send i kundërligjshëm apo i dyshuar se mund të përdorej për shitblerje të votës nuk u gjend në automjetin pa targa (Prova Nr. 9). Më datën 28.04.2021 u publikua një artikull, i cili në mënyrë shteruese trajtonte faktin se ngjarja e ndodhur ishte manipuluar nga ana e Policisë së Shtetit dhe kjo e fundit kishte mashtuar publikisht mbi faktet (Prova Nr. 10). Në procesverbalin u referimit të veprës penale nga Policia për Prokurorinë e Elbasanit përcaktohet se “në sedilen e djathtë përpara të këtij mjeti gjendet një çantë dore kafe, brenda së cilës gjenden dy kartëmonedha 50 euro [...] një fletore me vija me shënime në kapak Met Datilaku pagesë, brenda në 6 fletë shënime me emra dhe nr. id, format A4 me përshkrim formular patronazhi me tre fletë, 5 formate A4 me kopje kartash identiteti dhe pasaportash biometrike”. Gjetja e këtyre provave materiale nga ana e Policisë vërteton në mënyrë të qartë se personat e lartpërmendur janë përfshirë në skema kriminale të blerjes së votave dhe të marrjes së kartave të ID.
12. Shitblerja e votës është një ndër problematikat kryesore të konstatuara edhe në Deklaratën e Gjerjeve dhe Rekomandimeve Paraprake të Misionit Ndërkombëtarë të Vëzhguesve të OSBE/ODIHR (në vijim Misioni i OSBE/ODIHR). Koncretisht, në raport thuhet praktikisht gjithësisht të përhapura të shitblerjes së vota vazhduan të përbënin problem (shih fq. 2). Akuzat

per shitblerja votash ishin konstante gjate fushates, duke treguar se ky vazhdoi te perbente nje problem gjeresisht te perhapur. Struktura e Posacme e Anti-Korrupsionit (SPAK) e informoi MKVZ-në e ODIHR-it se deri me 24 prill 2021, kishte hapur me shume se 30 raste qe lidheshin me shitblerjen e votes. MKVZ-ja e ODIHR-it u informua, gjithashtu, nga prokurorë te Beratit dhe te Shkodres se kishin nisur hetimet per disa incidente te shitblerjes se votes. PD-ja depozitoi nje ankesë ne Struktura e Posacme Anti-Korrupsion (SPAK) qe permbante dhjetëra akuza per incidente shitblerjeje te votes ne Elbasan (shih fq. 14).

13. MKVZ-ja e ODIHR-it mori raportime te besueshme se koordinatorët e fushates se partive me te medha i ishin shtruar nje numri te konsiderueshem zgjedhesish nga komunitetet romë dhe egjiptiane per t'u bleje votat. OJQ-te romë raportuan se kjo praktikë eshte e zakonshme dhe se shume votues do t'i shisnin votat, te shtrë nga varfëria (shih fq. 18). Ne disa qarqe, MNVZ-ja vuri ne grupe djemsh te mbledhur jashte qendrave te votimit, qe dukeshin sikur kontrollonin zone dhe shimin se kush votonte. Ne qarkun e Shkodres, vëzhguesit vunë ne nje person qe tërhiqte dikë tjetër per ta futur ne qendren e votimit, dhe, ne momentin qe ky i dyti ishte brenda qendres se votimit, u udhezua per ke te votonte. Po ne këtë qark, MNVZ-ja qe dëshmitare e nje rasti te shpërndarjes se parave ne nje qendër votimi (shih fq. 19). Edhe Misioni i SHBA-ve ne OSBE deklaroi se blerja e votes ne zgjedhjet e 25 prillit 2021 mbeti nje problem i mjaft serioz.

A.2 Blerja e votes nepermjet dhënies se bonuseve dhe perfitimeve te tjera (5 prova)

14. Me 23.02.2021, Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar ne Prokurorinë e Posacme kunder Korrupsionit dhe Krimit te Organizuar – SPAK, nje kallëzim penal ndaj shtetasit Taulant Balla per veprat penale te "Korrupsionit aktiv ne zgjedhje", parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal dhe per veprën penale te "Përdorimit te funksionit publik per veprimtari politike ose zgjedhore". Ky kallëzim i bere nga ana e Partisë Demokratike vjen pasi shtetasi Taulant Balla duke shfrytezuar shfrytezuar vendimin nr. 85, date 10.02.2021 te Keshillit te Ministrave, shtetasi Taulant Balla, ka përdorur dyfishimin e perkohshem te ndihmes ekonomike per perfitime politike. Per këtë fakt, perfituesit e pagesës se ndihmes ekonomike ne Qarkun e Elbasanit jane njoftuar permes thirrjeve telefonike dhe/ose mesazhit me permbajtje si me poshte vijon: *"Përbëndetje, ju flet nga zyra e Shtabit te Taulant Ballës dhe dua tju informoj se ndihma juaj ekonomike është dyfishuar nga Shteti deri ne Qershor. Kjo është mundësuar nga Taulant Balla. Presim*

mbështetjen tuaj. Valminderit? Këto njoftime janë bërë nga numrat telefonike 0696038505, 0686059399, 0686067361, 0686052471 dhe 0686042338. Po përmes këtyre numrave telefonike, ndaj disa familjeve përfutuese të ndihmës ekonomike është bërë presion duke u kërkuar votën për Partinë Socialiste në këmbim të ofrimit/vijimit të ofrimit të ndihmës ekonomike (Prova 8).

15. Ndërkohë, në një denoncim të bërë publik në media, drejtuesi politik i Durrësit, Ardian Cela iu ka paguar 13 mijë punonjësve të OSHEE një rrogë plus gjatë fushatës elektorale të Partisë Socialiste me qëllim marrjen e mbështetjes për Partinë Socialiste (Prova Nr. 11).
16. Me Vendimin Nr. 1044, datë 18.12.2020 "Për një shtesë në vendimin Nr. 929, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave "Mbi krijimin e një fondi të posacëm", qeveria përcaktoi dhënien e një shpërblini fundviti për mjekët dhe punonjësit e Policisë së Shtetit. Mënyra e pagesës do të përcaktohej nga Fondi i Detyrueshem i kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (Prova Nr. 12).
17. Me Vendimin Nr. 1076, datë 24.12.2020, Qeveria ka vendosur të ndryshojë strukturën dhe nivelin e pagave për punonjësit e stafit mjekësor, punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe punonjësit e stafit teknik të shërbimeve mjekësore në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë, Njësisë Mjekësore Ushtarake në Spitalin Universitar të Traumës, në strukturat e Forcave të Armatosura dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (Prova Nr. 13). Ndërsa, me Vendimin Nr. 1102, datë 24.12.2020, Qeveria ka vendosur të akordojë fonde në vlera të ndryshme për kategori të ndryshme të popullsisë rurale nga fondi i posacëm për bujqësinë dhe zhvillimin rural (Prova Nr. 14).

B. Vendosja e shtetit në shërbim të Partisë, duke përdorur në mënyrë të paligjshme burimet shtetërore për devijimin e vullnetit të zgjedhësve (5 prova)

B.1 Shteti vendosi investimet publike në funksion të PS për zgjedhjet (shkelje e përsëritur 120 herë në të gjithë vendin):

18. Kryeministri Rama, ministrat, deputetët dhe kryebashkiakët e PS-së përdorën investimet publike për propagandë politike, në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe aktet nënligjore të nxjerra nga KQZ-ja. Në të paktën 20 raste në Qarkun e Elbasanit, për të cilat Partia Demokratike disponon foto dhe video, ndër të cilat janë të përfshirë deputetët e PS-së

në Elbasan, kandidatët për deputetë apo Kryetarët e Bashkiave promovuan investime publike me qëllime elektorale.

19. Për rastet që Partia Demokratike disponon foto dhe video, kandidati për deputet dhe Drejtuesi Politik i PS në Qarkun e Elbasanit, Taulant Balla, ka përdorur investimet publike për qëllime të fushatës zgjedhore në të paktën 11 raste; Kryetari i Bashkisë së Elbasanit në të paktën 4 raste, kandidati për deputet Besian Ajazi në 1 rast, Kryetari i Bashkisë së Cërrikut në 2 raste; Kryetari i Bashkisë Gramsh, shtetasi Klodian Tazi në një rast etj. (Prova Nr. 15).
20. Përdorimi i burimeve shtetërore për fushatë evidentohet edhe në Raportin Parsipak të OSBE/ODIHR. Konkretisht, Misioni shprehjet se pavarësisht një kundra ligjor solid që ndalon shpërdorimin e burimeve administrative dhe minimizon avantazhin e partisë në pushtet, ministrat vazhduan të bënin fushatë gjatë angazhimeve zyrtare. Publiciteti që erdhi si rrjedhojë e kësaj i dha partisë qeverisëse një avantazh të konsiderueshëm (shih fq. 2).
21. Ministrat vazhduan me angazhimet e tyre zyrtare gjatë gjithë fushatës. Ata u shfaqën rregullisht në “vizita inspektimesh” të objekteve kyce, si në qendrat e vaksinimit, me maska në fytyrë ose me bluza që lexonin “Nr. 12” (numri i PS-së në fletën e votimit), gjë që coi në publicitet të konsiderueshëm dhe që përbëri aktivitet për qëllime fushate. Edhe Kryeministri inauguroi disa projekte madhore infrastrukturore gjatë fushatës zgjedhore. Këto lloj aktiviteteve i dhanë një avantazh të konsiderueshëm PS-së, gjë që ishte përfunduar tashmë edhe me shumicë nga dominimi i PS-së në administratën lokale. (shih fq. 12).

B.2 Intimidimi i administratës shtetërore për të mbështetur PS:

22. Gjatë fushatës u konstatuan raste të shumta, të cilat janë denoncuar vazhdimisht nga Partia Demokratike se si të gjitha nivelet e administratës qendrore dhe vendore ishin përfshirë në fushatë, duke mbështetur publikisht kandidatët e PS-së. Drejtoritë vendore arsimore, drejtoritë vendore të bujqësisë, spitalet rajonale, shkolat e mesme, agjencitë vendore të kadastrës, administratat e policisë dhe burgjeve, gjendja civile etj., u kthyen gjatë fushatës zgjedhore në shtabë elektorale të PS-së.
23. Nëpunësit civilë ishin nën presion të vazhdueshëm për të mbështetur kandidatët socialistë, në të kundërt mund të shkarkoheshin nga detyra. Konkretisht, nëpunësve civilë iu kërkuar pjesëmarrje e detyrues në takime elektorale, dorëzimi i listës me votuesit në familjet e tyre, dhënia e kartave të identitetit dhe të dhënave të tjera personale, pëlqimi dhe shpërndarja e

posimeve në njetet sociale, përfshirja në fusharën derë më derë, dhënia e përfitimëve të ndryshme për simpatizantët e Partisë Socialiste. Nëpunës, të niveleve të ulëta dhe të mesme, të Autoritetit Rrugor Shqiptar kanë denoncuar presionin e vazhdueshëm nga eprorët e tyre për të parafutur një liste me 30 deri në 50 votues për Partinë Socialiste (emrat dhe kartat e identitetit) ose përndryshe do të perballeshin me masa disiplinore.

24. Nëpërmjet një grupi në WhatsApp, OSHEE Elbasan ka detyruar punonjësit të shpërndajnë me profile falco të gjitha statuset apo aktivitetet që Taulant Balla promovon në Facebook. **(Prova Nr. 16).**
25. Presionet ndaj nëpunësve publikë dhe detyrimi i tyre për t'u angazhuar në fushatë u evidentuan edhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR. Konkretisht, Misioni shprehet se ofrimi i stimujve dhe presioni i pretenduar ndaj nëpunësve civilë përben problem (shih fq. 2). MKVZ-ja e ODIHR-it mori edhe raportime për përpjekje të bëra për ndikim të votës përmes ofrimit të stimujve. Këtu futet edhe lëshimi i lejeve për legalizim. Në këto raporte pretendohet, gjithashtu, se shumë nëpunës civilë, një grup i punësuar që është vulnerabel ndaj presioneve, janë inkurajuar të votojnë për partinë qeverisëse (shih fq. 3).

B.2.1 Intimidimi i mbështetësve dhe kandidatëve (3 prova):

26. Në datën 14.03.2021, ora 10:00 sipas njoftimit zyrtar, Partia Demokratike e Shqipërisë zhvilloi një aktivitet me rastin e ditës së votës në bulevardin kryesor të qytetit të Elbasanit. Rreth orës 10:20, ndërsa kryetari PD-së z. Lulzim Basha po zhvillonte një takim në ambjentet e brendshme të ish hotel Turizmit dhe simpatizantët e PD-së po qendronin jashtë në sheshin e ish hotel Turizmit, përpara sheshit në krahun e kalasë së Elbasanit kaloi Kryeministri i Shqipërisë z. Edi Rama i shoqëruar nga antarë të grupeve kriminale, zyrtarët lokal dhe mbështetës së Partisë Socialiste. Ecja e Kryeministrit u shoqërua me thirrjen "Rama ik" nga ana e mbështetësve të opozitës. **(Prova Nr. 17).** Në këtë moment, shoqëruesit e Kryeministrit, disa prej të cilëve njëherazi ishin edhe anëtarë të grupeve kriminale, janë shkëputur prej tij dhe janë konfliktuar me mbështetësit e Partisë Demokratike **(Prova Nr. 18).**
27. Ndërsa më datë 18.03.2021, ora 15:00, pas një aktiviteti elektorale në "Labinot Fushë", është goditur me grushta në pjesën e kokës (fytirës) kandidati për deputet Z. Luçiano Boçi nga ana e shtetasit Gjergj Luca dhe persona të tjerë të paidentifikuar. Për ngjarjen në fjalë është njoftuar edhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan **(Prova Nr. 19).** Kandidati i Partisë Demokratike

në Elbasan, Lefter Gështrënja është kërcënuar me jetë nga bandat e lidhura me qeverinë në Elbasan, të cilat e ndalojnë nga pas kur ky i fundit po kthehet për në banesën e tij (Prova Nr. 20).

B.3 Punësime të reja në administratën publike, si shkelje e rëndë e ligjit për përfitim politik duke devijuar vullnetin (2 prova):

28. Nga viti 2017 e në vijim, Qeveria ka nxjerrë 28 vendime duke shtuar numrin e punësimeve në strukturat e qeverisjes qendrore me 16 645 pozicione të reja. Përveç kësaj punësimi në sektorin publik u rrit ndjeshëm në periudhën parazgjedhore, saktësisht në kohën para moratoriumit ndaj autorizimit të punësimeve të reja në administratën publike. Sipas INSIA1, midis tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit 2020, punësimi në sektorin publik është rritur me 6 për qind ose me 10.572 persona (Prova Nr. 21). Më 24 Dhjetor, qeveria autorizoi edhe 2.472 pozicione të tjera. (shih fq. 12 të Raportit Paraprak të OSBE/ODHIR) (Prova Nr. 22).
29. Sipas Ministrisë së Financave, për periudhën janar – prill 2021 janë paguar 20 milionë euro më shumë për paga krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020. Bazuar në të dhënat e Tatimeve shpenzimet për paga duke përfshirë edhe 244 institucione shtetërore të organizuara si shoqëri tregëtare, shpenzimet për paga nga shteti shqiptar llogariten në 63 milionë euro.
30. Me qëllim ndikimi në shtresat vulnerabël, bazuar në të dhënat e zyrtare të Ministrisë së Financave, qeveria ka paguar për ndihmën ekonomike për familjet në nevojë 313,763,706 lekë më shumë për periudhën janar – prill 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.
31. Po në të njëjtën periudhë, nga të dhënat zyrtare të Ministrisë së Financave, qeveria ka shpërndarë për 6.182 persona për “paga lufte” një vlerë prej 247,282,296 lekë.

B.4 Dhënia e lejeve të legalizimit/ndërtimit gjatë fushatës zgjedhore (2 Prova):

32. Deputetë të ndryshëm të Partisë Socialiste shpërndanë leje legalizimi në kundërshtim me përcaktimin e Kodit Zgjedhor dhe Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së. Në 9 raste, për të cilat Partia Demokratike disponon foto dhe video, ky kandidatë për deputetë shpërndanë leje legalizimi në periudhën e ndaluar nga Kodi Zgjedhor, me qëllim të qartë elektorale (Prova Nr. 23).

33. Në 29 Prill, u publikua një audio-përgjim i drejtorit të përgjithshëm të Kadasrës, Artan Lame, gjatë një takimi me vartësit e tij, ky i fundit u kërkon që mos procedojnë më tej me rreth 100.000 kërkesa për leje legalizimi të batesave private, të cilat me siguri do të refuzohen duke sjellë prishjen e tyre. Kjo pasi, refuzimi i dhënies së lejeve të legalizimit do të sillte që këta persona të votonin për opozitën. Në të kundërt, drejtori Lame kërkon që të përshpejtohet procedura për rreth 60.000 kërkesa për leje legalizimi, të cilat kanë mandesi të mëdha për t'u miratuar, në mënyrë që kjo të përkthet në mbështetje për Partinë Socialiste (**Prova Nr. 24**). Lëshimi i lejeve për legalizim në këmbim të votave në favor të PS së u evidentua edhe në Raportin e OSBE/ODIHR (shih fq. 13).

C. Përdorimi i paligjshëm i të dhënave personale: shteti vendosi të dhënat personal në dispozicion të serverave të PS në Tiranë dhe Elbasan (2 Prova):

34. Në datën 11 Prill, media publikoi një bazë të dhënash të 910.000 zgjedhësve që përdorte Partia Socialiste në Tiranë, duke bërë publike të dhënat personale si numri i ID, vendi i banimit, numri i telefonit dhe bindja politike, e shprehur në zgjedhjet e kaluara dhe projeksionet për zgjedhjet e 2021 (**Prova Nr. 25**). Ky database sipas medias ishte i instaluar në të gjitha zyrat elektorale të PS dhe lehtësisht i aksesueshëm për të gjithë personelin e shërbimeve elektorale të PS. Media më pas konfirmoi faktin se database të tilla kishte në çdo qark të Shqipërisë (**Prova Nr. 26**).
35. Sipas medias, të dhënat e PS janë marrë nga të dhënat shtetërore që qytetarët i kanë vënë në dispozicion në portalin e albania për të marrë shërbime gjatë pandemisë, apo në institucionet e tjera shtetërore për të marrë shërbime nga administrata, si pensionet apo dëmtshpërblimet e ndryshme për shkak të fatkeqësive si tërmeti etj. Shteti vendosi në dispozicion të partisë të dhënat e qytetarëve, dhe më pas këto të dhëna u shpërndanë çdo shtabi për të intimiduar qytetarët pasi ata (shtabi i PS) dinin gjithcka për ta, të dhënat personale, por edhe bindjen politike të tyre, shumë kohë para datës së zgjedhjeve.
36. Më 17 prill 2021, Kryeministri **Edi Rama** gjatë një takimi elektorale me të rinjtë në qytetin e Durrësit, falenderoi patronazhistët për punën e bërë (**Prova Nr. 27**). Fakti që vetë Kryeministri e pranoi këtë fenomen dhe e normalizoi përmes falenderimeve, tregon se databaza të njëjta me ato të publikuara (Qarku Tiranë dhe Durrës) kanë ekzistuar në të gjithë Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë edhe Elbasanin. Drejtuesi Politik i PS-së në Qarkun e

Elbasanit, në një deklaratë për mediat deklaroi se “patronazhistët na kanë mundur rezultatit më të lartë në Elbasan në 30 vite”, duke pranuar kështu ekzistencën e patronazhistëve edhe për këtë qark, ashtu sikundërse edhe për gjithë Shqipërinë (**Prova Nr. 28**).

37. Sic kemi shpjeguar në paragrafin 11 të këtij ankimi, ndër provat materiale të gjetura në automjetin pa targa në vendngjarje, rezultuan edhe disa fletë patronazhimi, gjë që tregon dhe vërteton katërcipërisht faktin se të dhënat personale të qytetarëve të Elbasanit, ashtu sikurse edhe të Qarkut të Tiranës ishin të përparuara në një databazë.
38. Skandali me të dhënat personale u evidentua edhe në Raportin përmprk të OSHE/ODHIR. Rrethja e të dhënave personale sensitive, duke përfshirë edhe preferencat politike të zgjedhësve përbën shqetësim serioz dhe i bën zgjedhësit vulnerabël (shih fq. 2). Gjatë fushatës, përmes një rrjedhjeve informacioni, në domeinin publik doli një databazë me informacione personale dhe detaje kontakti për afërsisht 900.000 qytetarë shqiptarë, që përmbante edhe preferencat e tyre potenciale të votimit. Ekzistenca e kësaj databaze në domeinin publik u konfirmua në mënyrë të pavarur nga MKVZ-ja e ODHIR-it. Disa bashkëbisedues të MNVZ-së nga partitë kryesore politike besonin se një incident i tillë mund të konsiderohej nga elektorati si shpërdorim i të dhënave personale për interese të partive (shih fq. 12).

D. Mohimi i të drejtës për të votuar i emigrantëve (2 Prova)

39. Deri në datën 19.04.2021, nuk ka patur asnjë ndalim që emigrantët shqiptarë, të hyjnë në Shqipëri (vendlindjen e tyre) dhe të vendoseshin në karantine. Komiteti Teknik i Ekspertëve pranë Ministrisë së Shëndetësisë, vetëm 1 javë para zgjedhjeve, nxori një vendim që detyronte emigrantet që vinin nga Greqia apo Maqedonia e Veriut të karantinoheshin detyruesisht për një periudhë 2-javore (**Prova Nr. 29**). Ky vendim pengonte efektivisht mbi 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës, në mënyrë diskriminuese.
40. Pavarësisht se nenet 24 dhe 25 përcaktojnë të drejtën e shtetasve shqiptarë, që jetojnë jashtë Shqipërisë, për të votuar aty ku ata jetojnë, administrata zgjedhore nuk bëri asgjë që të garantonte efektivisht këtë të drejtë. Sipas të dhënave të INSTAT për vitin 2020, numri i shtetasve shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë Shqipërisë është 1.68 milion ose 44.5% e totalit të numrit të zgjedhësve. Për më tepër, 600 mijë emigrantëve që jetojnë në Greqi, iu mohua efektivisht e drejta për të votuar, duke vendosur detyrimin e karantinimit vetëm një javë

përpara zgjedhjeve. Detyrimi për t'u karantinuar u shfuqizua në datën 3 Maj, një javë pas përfundimit të zgjedhjeve (Prova Nr. 31).

41. Mohimi i të drejtës për të votuar i shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë Shqipërisë u evidentua edhe në Raportin paraprak të OSBE/ODIHR. Konkretisht, Misioni shprehet se megjithëse në Kodin Zgjedhor parashikohet si mundësi, qytetarëve nuk iu ofrua mundësia për të votuar jashtë vendit. Megjithatë, votuesit që jetojnë jashtë mund të kthehen dhe të votojnë në qendrat perkatese të votimit; megjithëse në praktikë, kjo mund të jetë penguar nga masat e marra për shkak të COVID-19 (shih fq. 7). Një numër i konsiderueshëm zgjedhësish jetojnë jashtë vendit. Shumica e tyre nuk mundën të votojnë për shkak të mundësisë për të votuar jashtë shtetit dhe kufizimeve të vendosura ndaj udhëtimeve për shkak të COVID-19 (shih fq. 19).

D.1 Mohimi i të drejtës për të votuar të infektuarve me COVID-19:

42. Zgjedhësit që ishin infektuar me COVID-19 dhe që ndodheshin në karantinë, qenë të detyruar të respektonin rregullat e izolimit, duke cuar de facto në mohimin e së drejtës së tyre për të votuar. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, numri i personave të infektuar me COVID-19 në ditën e zgjedhjeve ishte rreth 23.000. Kjo praktikë bie ndesh përkatësisht me dispozitat për të drejtat e votimit dhe barazinë e votës të parashikuara në nenin 45 të Kushtetutës dhe me paragrafin 7.2 të Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 të OSBE-së. (shih fq. 8 të Raportit paraprak të OSBE/ODIHR).

E. Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor:

43. Në datën 30.07.2020, Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet ligjit Nr. 115/2020 miratoi nismën e Partisë Socialiste për disa ndryshime kushtetuese, të cilat në thelb sanksiononin: (i) heqjen e kolicioneve parazgjedhore; (ii) sistemin me votim preferencial për 2/3 e kandidatëve; dhe (iii) vendosjen e një pragu kombëtar. Në vijim të ndryshimeve kushtetuese, Kuvendi i Shqipërisë miratoi në datën 05.10.2020 disa ndryshime në Kodin Zgjedhor, të cilat kishin të bënin me: (i) ulja nga 3% në 1% e pragut kombëtar; (ii) renditja e kandidatëve që përfitojnë mandat ndryshon nëse kandidati ka marrë një numër votash parapëlqyese më të madh se herësi që del nga pjesëtimi i numrit të votave të subjektit me numrin e mandateve të fituara; (iii) ri-renditjen

e listës fituese sipas kandidatëve që kanë fituar numër votash më të madh se hërës; dhe (iv) kryetari i partisë ka të drejtë të kandidojë deri në katër qarqe.

44. Ndryshimet e njëanshme në Kodin Zgjedhor nga Partia Socialiste, duke shkelur marrëveshjen konsensuale me KQZ-në, u evidentuan si problematike edhe nga Misioni i OSBE/ODIHR. Konkretisht, Misioni shprehët se disa bashkëbisedues të MKVZ-së së ODIHR-it, duke përfshirë edhe në KQZ, u shprehën se ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor krijuan një sërë paqartësish dhe ngritën shqetësime rreth kapacitetit teknik për zbatimin e tyre, sidomos në kohën e shkurtër mes ndryshimeve dhe zgjedhjeve (shih fq. 5).
45. Në Opinionin e tyre të Përbashkët, Komisioni i Venecias të Këshillit të Evropës dhe ODIHR-i shprehën keqardhje që procedurat e miratimit të ndryshimeve në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor kishin qenë jashtëzakonisht të çaktuara dhe që nuk ishin parapritë nga një proces i duhur konsultimi. Ata vunë gjithashtu në dukje se ndryshimet në lidhje me numrin minimal të kandidatëve përbëjnë disavantazh për partitë e vogla dhe se mundësia që u jepet drejtuesve të partive që të kandidojnë në disa zona zgjedhore njëherësh përbën shkelje të së drejtës së kandidimit në kushte të barabarta (shih Opinionin e përbashkët të Komisionit të Venecias dhe ODIHR-it në vitin 2020).

E.1 Numri i madh i fletëve të votimit të pavlefshme (6 prova):

46. Në 31.03.2021, Komisioneri Shtetëror miratoi fletët e votimit, e cila përmbante logon e partisë, emrin e subjektit/koalicionit, emrin e kryetarit të partisë dhe emrat e kandidatëve për deputetë (**Prova Nr. 31**). Ky vendim i Komisionerit u ankimua nga Partia Socialiste, e cila kërkoj që fleta e votimit të ishte vetëm me NUMRA, PA EMRAT e kandidatëve. Në datën 03.04.2021, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve vendosi të pranojë ankimin e PS për të miratuar një fletë votimi vetëm me numra, pa emrat e kandidatëve (**Prova Nr. 32**). Ndaj këtij vendimi, u ushtua ankim nga Partia Demokratike në Kolegjin Zgjedhor, i cili në 04.04.2021 vendosi të lërë në fuqi vendimin e KAS-it (**Prova Nr. 33**). Kompania Celtes, e cila ishte ngarkuar me prodhimin e fletëve të votimit, informoi në të njëjtën ditë KQZ se afati 10-ditor për prodhimin e fletëve të votimit është "një mision i pamundur", duke kërkuar minimalisht 20 ditë (**Prova Nr. 34**).
47. Në kohën e shkurtër të mbetur në dispozicion nga dita e votimit, KQZ bëri një fushatë sensibilizuese mbi mënyrën se si qytetarët duhet të votojnë që fleta e votimit të ishte e

vlefshme. Megjithatë, kjo nuk e uli numrin e votave të pavlefshme, të cilat sipas të dhënave zyrtare të KQZ së ardhën në 83.028 vota ose 5% e totalit të numrit të votuesve (Prova Nr. 35).

48. Ky fakt u evidentua edhe në Deklaratën e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake, të publikuar në datën 23.04.2021 nga Misioni Ndërkombëtar i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR, i cili në faqen 7 shprehet (citim): "...fushata e informimit të zgjedhësve ishte e pamjaftueshme dhe se kishte filluar me vonesë, sidomos sa i përket identifikimit të zgjedhësve dhe konfigurimit të ri të fletës së votimit. Kjo kontribuoi në krijimin e një konfuzioni në ditën e zgjedhjeve."
49. Ndërsa datën 28.04.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve bëri një deklaratë për shtyp, si vijon: "Nëse fleta e votimit do ishte me errta, ndoshta do ishte ndryshe. Por, vendimmarrja e CAS-it dhe Kolegjit vlerësoi që informacioni mund të ishte më i thjeshtë për votuesit. Kemi 83 mijë fletë votimi të pavlefshme. Para se KQZ t'i dëgj ndoshta është mirë që të shohim ato fletë votimi që janë vlerësuar të pavlefshme, për çfarë arsye është." (Prova Nr. 36).

E.2 Diskriminimi i kandidatëve gjatë procesit zgjedhor

50. Ligji u lejon vetëm kryetarëve të partive, por asnjë kandidat tjetër, që të kandidojnë deri në katër zona zgjedhore, ndërkohë që kandidatët e tjerë mund të kandidojnë vetëm në një zonë, gjë që përbën shkelje të së drejtës së kandidimit në kushte të barabarta (shih fq. 2, Raporti Paraprak i OSBE/ODIHR).

F. Votimi më shumë se një herë

51. Një nga risitë e zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në 25 prill 2021 ishte identifikimi elektronik i zgjedhësve, i cili nënkupton identifikimin e zgjedhësit nëpërmjet verifikimit të të dhënave personale nga leximi me pajisje dhe përqasja e tyre me bazën elektronike të të dhënave, si dhe regjistrimi në pajisje i shenjave daktiloskopike. Futja e këtij mekanizmi të ri në Kodin Zgjedhor ishte kërkuar me forcë nga PD dhe kishte qenë pjesë e konsensusit të arritur ndërmjet palëve për ndryshimet e Kodit Zgjedhor në Korrik 2020. Nëpërmjet identifikimit elektronik synohej të eliminohet votimi më shumë se një herë, në të njëjtën qendër votimi apo qendra të tjera, të eliminohet votimi për të tretën apo votimi familjar.

52. Megjithatë, për shkak të kohës së shkurtër në dispozicion, mosrealizimeve të auditimeve të pavarura dhe konsultimeve me publikun, sic konstaton me të drejtë Misioni i OSBE/ODIHR në Raportin paraprak (shih fq. 2, 7, 19), pati probleme me vetien në punë të pajisjeve, operatorëve të kualifikuar, përdorimit, ndërprerjes së energjisë etj. Por, gjithësesi ajo që mbetet problematike është fakti se nga informacionet e marra në terren nga strukturat e Partisë Demokratike rezultoi se gjithësesi pajisjet e identifikimit elektronik nuk e eliminuan fenomenin e votimit të dyfishtë, votimit për të tretët apo familjarë, apo falsifikimin e identitetit të zgjedhësve. Kjo pasi pavarësisht mjetit të identifikimit të paraqitur, pajisja e identifikimit elektronik pranonte edhe shenjat daktiloskopike të personave të tjerë të ndryshëm nga poseduesit e mjeteve të ID.
53. Në ditët pas ditës së zgjedhjeve, në rrjetet sociale qarkullojë një video, ku disa persona testonin pajisjen e identifikimit elektronik, e cila pranonte shenjë të gishtërinjve të personave të tjerë, pavarësisht mjetit të identifikimit të paraqitur. Nisur nga ky shqetësim se pajisjet e identifikimit elektronik, jo vetëm nuk kanë eliminuar votimin e dyfishtë, por mund ta kenë lehtësuar, në datën 6 maj 2021, Komisioneri dhe Zv.komisionerja Shtetërore e Zgjedhjeve u shprehën se pas kthimit të pajisjeve të identifikimit elektronik nga qendrat e votimit, aktualisht është duke u kryer kryqëzimi i të dhënave për të verifikuar rastet kur zgjedhës të caktuar kanë votuar në qendra votimi të ndryshme apo brenda të njëjtës qendër votimi. Kjo tregon që shqetësimi i ngritur për votimin e dyfishtë, votimin për të tretët apo familjarët, është një shqetësim i drejtë dhe i bazuar.
54. Në pëmbledhje të fakteve deri në datën 25.4.2021 del qartë se i gjithë **SHTETI U VU NË DISPOZICION TË PARTISË, SHTETI DHE PARTIA (PS) U BËNË NJË.**

II. E DREJTA E APLIKUESHME

55. Kushtetuta e Shqipërisë:

- (i) **Neni 1** parashikon se: “3. Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike.”
- (ii) **Neni 18** parashikon se: “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.”
- (iii) **Neni 35** parashikon se: “1. Askush nuk mund të detyrohet përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij. 2. Mbledhja, përdorimi dhe bërja

publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.”

- (iv) **Neni 45** parashikon se: “1. Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. 4. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.”

- (v) **Neni 64** parashikon se: “3. Zgjedhësit gëzojnë të drejtën për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatit e listave shumëmërore. Kriteret dhe rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor, për caktimin e zonave zgjedhore, pragun kombëtar, numrin e mandateve për secilën zonë, shpërndarjen e mandateve dhe masën e shtrirjes së votimit parapëlqyes përcaktohen në ligjin për zgjedhjet. Ligji për zgjedhjet garanton që votimit parapëlqyes t’i nënshtrohen jo më pak se dy të tretat e listës shumëmërore dhe të sigurojë përfaqësimin gjinor.”

56. **Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut:**

- (i) **Neni 3, Protokolli 1** parashikon se “Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjet e organit ligjvënës.”
- (ii) **Neni 8** parashikon se: “1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij dhe familjare, batesës dhe korespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

57. **Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore:**

- (i) **Pika 27** parashikon se: “Liria e zgjedhësve për të shprehur vullnetin e tyre kërkon, para së gjithash, zbatimin rigoroz të procedurës së votimit. Në praktikë, zgjedhësit duhet të kenë mundësi të hedhin votat e tyre për listat e regjistruara ose për kandidatit, gjë që do të thotë se atyre duhet t’u vihen në dispozicion fletët e votimit me emrat e kandidatëve, dhe ata duhet të kenë mundësi të hedhin fletet e votimit në kutitë e votimit.”

- (ii) **Pika 49** parashikon se: "Është mirë që të shmanget shpallja e shumë fletëve të votimit si të pavlefshme ose të prishura. Në rast dyshimi, duhen bërë përpjekje për të mesuar se cili ka qenë qëllimi i votuesit."

58. **Kodi Zgjedhor:**

- (i) **Neni 2** parashikon se: "27. "Identifikimi elektronik" është identifikimi i zgjedhësit nëpërmjet verifikimit të të dhënave personale nga leximi me pajisje dhe përqsja e tyre me bazën elektronike të të dhënave për listën e zgjedhësve të qendrës së votimit, si dhe regjistrimi në pajisje i shenjave daktiloskopike. 29. "Votimi për të tretët" është votimi kur zgjedhësi voton në emër dhe për llogari të personave të tjerë, të pranishëm ose jo në qendrën e votimit. Përvetse kur bëhet votimi i asistuar sipas këtij ligji, votimi për të tretët është i kundërligjshëm dhe dënohet sipas Kodit Penal. 30. "Votim familjar" është formë e votimit për të tretët dhe ndodh kur një pjesëtar i familjes, si rregull kryefamiljari, voton në emër dhe për llogari të pjesëtarëve të tjerë."
- (ii) **Neni 12** parashikon se: "5. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) është organ kompetent për shqyrtimin e ankimeveve administrative dhe për vendosjen e sanksioneve për shkelje të ligjit zgjedhor."
- (iii) **Neni 21** parashikon se: "1. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, KAS i ushtron këto kompetenca: a) vendos për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në një ose më shumë qendra votimi, në një ose më shumë zona zgjedhore apo në të gjithë vendin, si dhe për përsëritjen e pjeshme ose të plotë të zgjedhjeve."
- (iv) **Neni 24** parashikon se: "1. KQZ-ja udhëheq dhe mbikëqyr procesin për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundesojnë votimin nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvendin, për zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kanë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit dhe kërkojnë nga KQZ-ja që të pajisen me dokumentacionin e votimit nga jashtë."
- (v) **Neni 25** parashikon se: "1. Pavarësisht nga procedura e votimit, manuale ose elektronike, votat e votuesve nga jashtë vendit administrohen nga KQZ-ja, duke garantuar integritetin e votimit dhe fshehtësinë e votës nga çdo ndërhyrje mbi fletët e votimit ose mbi informacionin elektronik të votimit që administrohet prej saj."

- (vi) **Neni 33** parashikon se: "KZAZ ja kryen këto detyra: ë) përgatit dhe miraton tabelën përmbledhese të rezultatit të zgjedhjeve për çdo subjekt zgjedhor në ZAZ dhe ia dërgon atë KQZ-së, së bashku me materialet e tjera të nevojshme, në përputhje me nenin 122 të këtij Kodi."
- (vii) **Neni 78** parashikon se: "6. Ndalohej zhvillimi i fushatës zgjedhore në institucionet publike. 7. Subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve u ndalohej dhe tubajnë përgjegjësi penale në rast se ofrojnë ose japin të holla, të mira materiale, premtojnë për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike."
- (viii) **Neni 91** parashikon se: "1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj entit tjetër ku shteti zotëron kapitale ose kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit apo pronësia. 2. Në kuptim të këtij neni "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të "burimeve njerëzore" kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorim i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimit, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim. 3. Gjatë fushatës zgjedhore ndalohej marrja në punë, pushimi nga puna, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. 4. Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohej propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënie të përfitimeve për kategori të caktuara popullsisë, të tilla si akret që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale,

uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e atomistive fiskale, privatimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.”

- (ix) **Neni 92** parashikon se: “6. Mosraportimi i veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarzjeve shtetërore, ose zhvillimi i tyre, pavarësisht ndalimit nga KQZ-ja ngarkon me përgjegjësi personin përgjegjës, si dhe mullarin përkatës të institucionit kur ai ka penguar zbatimin e kësaj dispozite.”
- (x) **Neni 98** parashikon se: “4. Fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin duhet të përmbajë hapësirën e posacme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor. Mënyra e votimit parapëlqyes përcaktohet nga KQZ-ja në varësi nga numri i subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje, duke respektuar kushtin që informacioni i përcjelle nga fleta e votimit të mos jetë tejte i ngarkuar, konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer.”
- (xi) **Neni 106** parashikon se: “1. Pasi merr fletën e votimit, zgjedhësi hyr i vetëm në dhomën e fshehtë dhe në fletën e votimit shënon në vendin e përcaktuar nga fleta e votimit për subjektin zgjedhor dhe/ose kandidatin e parapëlqyer të subjektit zgjedhorë shenjë “x” ose “+” ose një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij.”
- (xii) **Neni 116/1** parashikon se: “5. Në përfundim të numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit të ZAZ-së, kutitë e materialeve të votimit dërgohen në KQZ së bashku me kutinë e votimit. Kutitë e materialeve të votimit hapen në KQZ gjatë fazës së shqyrtimit të ankimit, në përputhje me nenin 136 dhe/ose pikën 1 të nenit 138 të Kodit, nëse provat e kërkuara administrohen sipas këtij Kodi, në kutinë e materialeve të votimit.”
- (xiii) **Neni 117** parashikon se: “2. Vota të vlefshme janë vetëm fletët e votimit, në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore dhe/ose vetëm për njërin nga kandidatët e tij. Kur është votuar për më shumë se një kandidat të të njëjtit subjekt zgjedhor, vota i llogaritet vetëm subjektit zgjedhor. 3. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur: a) fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja; b) fletës së votimit i mungojnë vultat e parashikuara në nenin 103 të këtij Kodi; c) në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës; ç) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore; d) është votuar

për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit; dh) nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit; e) është votuar për një subjekt zgjedhor dhe për kandidatin e një subjekti tjetër zgjedhor; e/l) nuk është e qartë se për kë është votuar; ose ë) zgjedhësi ka votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit. 4. Vlerësimi i votave synon të identifikojë, sa të jetë e mundur, qëllimin e zgjedhësit.”

- (xiv) **Neni 123** parashikon se: “1. KQZ-ja verifikon dhe nxjerr rezultatet e votimit për zonën zgjedhore për Kuvendin apo për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse. Për këtë, KQZ-ja plotëson Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore dhe e miraton atë me vendim jo më vonë se 48 orë nga mbërritja e të gjitha tabelave të zonës zgjedhore. 4. Vendimi i KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, sipas këtij neni, mund të ankimohet po në KAS, sipas procedurave të parashikuara në pjesën X të këtij Kodi. 5. Vendimi i KZAZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zgjedhjeve të ZAZ-së, çdo vendim i KZAZ-së, i marrë gjatë procedurës së marrjes në dorëzim të materialeve dhe dokumentacionit zgjedhor nga KQV-të, si dhe gjatë numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit të votimit, janë vendime të ndërmjetme dhe ankimohen në KAS së bashku me ankimin kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, të marrë sipas pikës 1 të këtij neni.”

- (xv) **Neni 123/1** parashikon se: “1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të paleve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethën e kompetencave të KQZ-së. 2. Kërkesat ose ankesat e subjekteve zgjedhore trajtohen sipas procedurës së përcaktuar nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore të dalë në zbatim të tij.”

- (xvi) **Neni 124** parashikon se: “1. Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit. 3. Kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, të marrë sipas nenit 123 të këtij Kodi,

mund të paraqitet ankimi po në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhese të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi.”

(xvii) **Neni 143** parashikon se: “1. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit KQZ-ja vendos sipas rastit: ç) shpalljen e zgjedhjeve të pavlefshme në një ose disa qendra votimi të zonës zgjedhore ose në të gjithë njësinë zgjedhore; d) lënien në fuqi ose ndryshimin e vendimit për miratimin e tabelës përmbledhese të rezultatit të zgjedhjeve, sipas nenit 122 ose nenit 123 të këtij Kodi.”

(xviii) **Neni 152** parashikon se: “2. Ankimi për të gjitha vendimet që KQZ-ja merr në periudhën, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesëshme ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tyre. Për vendimet që KQZ-ja merr jashtë kësaj periudhe, afati i ankimit në Kolegjin Zgjedhor është 30 ditë.”

(xix) **Neni 160** parashikon se: “KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi, në rast se: a) kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shprehje, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore.”

(xx) **Neni 161** parashikon se: “1. Pas përfundimit të procesit të ankimit, jo më vonë se 3 ditë nga nxjerja e rezultatit të zonës zgjedhore, KQZ-ja kryesisht ose me kërkesë të subjektit shpall të pavlefshme dhe urdheron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore, kur pavlefshmëria e shpallur në një ose disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi, ndikon në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore ose në shkallë vendi.”

59. **Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”:**

(i) **Neni 6** parashikon se: “1. Të dhënat personale përjetojnë vetëm: a) nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin; b) për hartimin dhe përmbushjen e kontratave, në të cilat subjekti i të dhënave personale është palë; c) për të mbrojtur interesat jetikë të

subjektit të të dhënave; ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit; d) për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të kontrolluesit ose të një pale të tretë, të cilës i janë përhapur të dhënat; dh) për ndjekjen e interesave legjitime të kontrolluesit ose të një pale të tretë, të cilës i janë përhapur të dhënat, përveç kur këta interesat mbizotërojnë mbi interesat për mbrojtjen e të drejtave dhe lizive themelore të subjektit të të dhënave.”

- (ii) **Neni 7** parashikon se: “1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, ndalohej përpunimi i të dhënave, që zhulojnë origjinën racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësinë në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimet penale, si dhe shëndetin dhe jetën seksuale.”

60. **Vendimi Nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator:**

- (i) **Neni 3** parashikon se: “1. Në zbatim të këtij vendimi: 1.1 “veprimtari të ndaluara për t’u promovuar” janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rrethet apo pusacerisht në dispozicion, apo janë transferuar forat publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në përmbledh 4 (afër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë: a) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut; b) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, si dhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik; c) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve për mbrojtjen dhe ruajtjen e monumenteve dhe të objekteve të paluajtshme të karakterit arkeologjik, historik, kulturor e shkencor dhe të objekteve publike, ose për mbrojtjen dhe ruajtjen e objekteve të luajtshme me vlerë institucionale, historike, arkeologjike, kulturore ose shkencore; ç) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi; d) mbështetjen dhe promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësisë natyrore. 1.3 “veprimtari të ndaluara”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë: a) shpërndarjen në veprimtari publike të lejeve të legalizimeve, në periudhën

4 (katër) muajore para datës së zgjedhjeve; b) shpërndarjen në veprimtari publike të akteve për regjistrimin e tokës bujqësore, certifikatave të pronësisë, dhe çfarëdoj titulli pronësie sipas legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, si dhe të regjistrimeve të tilla të pronësisë sipas ligjit Nr. 111/2018, "Për kadastrën" në periudhën 4 (katër) muajore para datës së zgjedhjeve; b) vënie në dispozicion të aseteve të hajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose në nivel të njesive të vetëqeverisjes vendore, apo edhe entit tjetër ku shteti zotëron kapital/knota/akcione dhe/ose emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit; c) përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimtari dhe ose aktivitete për qëllime zgjedhore edhe me mjete të komunikimit elektronik, si dhe përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve, ose premimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mesimit, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim; d) gjatë fushatës zgjedhore, marrja në punë, pushimi nga puna, liri, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, shtesat në organiken e çdo institucioni publik e shtetëror apo emërime provizore, me përjashtim të rasteve të përligjura; dh) kontrollat dhe verifikimet e bizneseve regjistruara dhe operatorëve në kundërshtim me procedurat ligjore dhe veprimtarinë institucionale. 3. Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndaloher propozimi, miratimi i akteve ligjore ose nënligjore, ose nxjerrja e tyre me qëllim informimin e publikut në lidhje me vendimmarrjen e institucionit miratues në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë krijen e pagave, pensioneve, mbështetjen ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, faljet e kamatëve, të gjuhëve, të detyrimeve tatimore e doganore, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore ose të epidemisë/pandemisë, apo ka si qëllim zbatimin e një detyrimi ligjor me karakter